



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

### EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 28 janar 2016, në mbledhjen e XXIV-të  
(njëzetekatër) të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.10'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti: Bahri Blakçori, Islam Revuçi, Fidan Rekaliu, Haki Rudari, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullahu – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe z. Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Avni Maloku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe Muharrem Haziri, OSBE.

#### 1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

#### 2. Shqyrtimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa më 29 dhjetor 2015

z. Mynavere Abdullahu – Krasniqi, propozoi që në diskutimin e saj në faqen 2 ku thuhet, vlerat natyrore për të cilat po debatojmë kanë vlera të shumëfishta shkencore, kulturore dhe të tjera, andaj është e nevojshme të vihen nën mbrojtje të them monumentet e cekura”, të korrigjohet si vijon:

*Mbështes propozim vendimin për mbrojtjen e këtyre monumenteve natyrore, duke pas parasysh se këto monumente natyrore për Komunën tonë janë me rëndësi të shumëfishtë, si në edukim, shkencë, kulturë, turizëm. Andaj është e domosdoshme mbrojtja e tyre”*

*Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri me vërejtjen e parafolëses.*

#### 3. Propozimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal – SZHEL për periudhën 2016 – 2018

- Vendimi për vënie në diskutim publik

z. Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, e paraqiti fjalën hyrëse.

**z. Fidan Rekaliu**, theksoi, Grupi i këshilltarëve e mbështet propozimin e këtij dokumenti ngase jemi të mendimit se kjo Strategji do të ndikoj në një masë në zhvillimin ekonomik të Komunës tonë. Përshtypje më ka lënë përshtypje, siç e ceku drejtori z. Avni Fetahu në fjalën hyrëse, se është Strategji mjaftë konkrete dhe mbi këtë bazë jam i bindur se shumica e projekteve të planifikuara do të realizohen gjatë kësaj periudhe.

**z. Rafet Llapashtica**, theksoi, në parim e mbështes, por jo në tërësi, që Kuvendit t'i rekomandohet për shqyrtim dhe që të mos i përsëris çështjet, diskutimin tim do ta paraqes në mbledhje të Kuvendit.

**z. Kadri Avdiu**, theksoi, duke u bazuar se propozimi i kësaj Strategjie pas miratimit në kuvend do të vihet në diskutim publik e mëpastaj do të shqyrtohet sërish në këtë Komitet dhe në Kuvend, konsideroj se është kohë e mjaftueshme kur do t'i kemi mundësitë për t'i dhënë vërejtjet dhe plotësimet tona.

**z. Haki Rudari**, theksoi, Grupi i këshilltarëve i LVV – së në parim e përkrahë propozimin e kësaj Strategjie në të cilën ka gjëra mjaftë të mira por Ekzekutivi duhet të bëjë përpjekje që projektet e parapara të mos mbeten vetëm në letër por të realizohen sipas dinamikës së planifikuar.

**z. Naim Çunaku**, theksoi, pajtohem me parafolësit por unë i kam disa vërejtje apo sugjerime dhe atë në pjesën e kësaj Strategjie ku bëhet fjalë për burimet natyrore, sa unë jam në dijeni edhe kryesuesit të Kuvendit i është dërguar një shkresë nga banorët e fshatit Shakovicë të cilët në një formë nuk po ndihen mirë ngase sipas përkufizimeve kadastrale përkatësisht ndarjes së fshatrave Shkolla Fillore “ Afrimi dhe Fahriu “ thuhet se është në Lluzhan e në realitet është në Shakovicë, për Qendrën e Mjekësisë Familjare që është në Shakovicë sërish thuhet se është në Lluzhan.

Gjithashtu i njëjti gabim është përvjedhur ku bëhet fjalë për burimet natyrore është Banja e Sallabajës dhe në kllapa që e ka kuptimin e sqarimit thuhet Lluzhanit. Ne i kemi dy banja që njhen në popull dhe atë banja me ujë mineral apo Ilixha e Sallabajës, pra duhet të hiqet fshati Lluzhan, dhe Banja e Shakovicës që njhet për burimin e saj të ujit termomineral.

Krejtësisht në fund, kisha dëshiruar që kjo Strategji të jetë një dokument i mirë për zhvillimin e komunës dhe në të të inkorporohen idetë, propozimet dhe sugjerimet e qytetarëve.

Gjithashtu kisha dëshiruar që në këtë Strategji të zë më shumë vend Drejtoria e Arsimit në veçanti një vend më meritor ta zënë rregullimi i oborreve të shkollave dhe shkollat të cilat nuk kanë fusha sportive.

**Kryesuesi z. Mehmet Gashi**, theksoi, janë të mirëseardhura të gjitha idetë, vërejtjet, plotësimet dhe sugjerimet të cilat mund të paraqiten në mbledhje të këtij Komiteti, gjatë kohës sa është në diskutim publik ky dokument e gjithësesi edhe në mbledhje të Kuvendit.

Ndërkaq sa i përket vërejtjes të parafolësit, çështjet e cekura duhet të harmonizohen me dokumentacionin zyrtar.

**z. Avni Maloku**, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, theksoi, sa i përket emërimit të shkollave kompetente është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, andaj çështja e cekur nuk ka të bëjë me Drejtorinë e Arsimit por me Drejtoritë tjera kompetente, por jam i mendimit se selia Shkollës dhe Qendrës së Mjekësisë Familjare duhet të jetë sipas dokumentacionit zyrtar të komunës.

Kuvendit, në funksion të harmonizimit me Zona Kadastrale, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim, me korrigjim të propozim Strategjisë të bëhen korrigjimet si vijon:

*Pas votimit u konstatua se Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim me korrigjim si vijon:*

*Te burimet natyrore, faqe 14*

*- Banja e Sallabajës ( Lluzhan ) të korrigohet, lligja e Sallabajës, dhe  
- Banja e Shakovicës të korrigohet Burimi termomineral dhe që debati me qytetarë të zgjatë 60 ditë, ndërsa data e debati me qytetarë të caktohet në mbledhje të Kuvendit.*

#### **4. Informatë për përfundimin e suksesit të nxënësve në gjysëmvjetorin e parë dhe fillimin e gjysëmvjetorit të dytë të vitit shkollor 2015 – 2016**

**z. Avni Maloku**, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, e paraqiti fjalën hyrëse.

**z. Fidan Rekalu**, theksoi, Grupi i këshilltarëve i LDK – së e mbështet këtë Informatë dhe propozon që e njëjta t'i rekomandohet Kuvendi për shqyrtim.

**z. Rafet Llapashtica**, theksoi, grupi i këshilltarëve i PDK – së në parim e mbështet këtë Informatë ndërsa vërejtjet do t'i paraqet në mbledhje të Kuvendit.

**z. Haki Rudari**, theksoi, e falënderoj drejtorin e Drejtorisë së Arsimit për paraqitjen e kësaj informate, mirëpo jam i mendimit se duhet të krijohet një praktikë që në periudha të caktuara të procesit të vitit shkollor të paraqiten informata përkatëse, ngase në këtë mënyrë ngritët transparenca.

Jam i vetëdijshëm se sa i përket suksesit të nxënësve raportet dërgohen nga shkollat përkatëse, andaj niveli i suksesit të nxënësve është përgjegjësi e mësimitdhënësve, por pjesa tjetër e përgjegjësisë është e Drejtorisë së Arsimit siç është pranimi i kuadrove etj.

Theksova se në parim e mbështesim këtë informatë por vërejtjet tona do t'i paraqesim në mbledhjen e nesërme të Kuvendit.

Pas votimit u konstatua se kjo Informatë, Kuvendit i rekomandohet njëzëri për shqyrtim.

#### **5. Propozimi i Raportit të punës të Kuvendit të Komunës për vitin 2015**

**Kryesuesi z. Mehemt Gashi**, e paraqiti fjalën hyrëse.

Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

**Mbledhja përfundoi në orën 14.00'**

**Procesverbalin e mbajti**

**Faik Gashi**

**Nr. 01- 006-7317**

**Podujevë,**

**28 janar 2016**

**Kryesuesi i Komitetit  
Mehmet Gashi**